

VENDIM
Nr. 536, datë 4.10.2017

**PËR MIRATIMIN E BUXHETIT PËR DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË
PRONËSISË INDUSTRIALE PËR VITIN 2017**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 189/c, të ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e buxhetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale për vitin 2017, sipas tabelës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

TË ARDHURAT		në	SHPENZIMET		në
mijë			mijë		
Aktivitet kryesor		24,000	Shpenzime personeli		10,000
Marrëveshje e Madridit		69,438	Shpenzime operative		12,837
Anëtarësim në EPO		399	Shpenzime kapitale		71,000
TOTALI I TË ARDHURAVE		98,837	Totali i shpenzimeve		93,837